

ABSTRAKT

Roli dhe Rëndësia e Byrosë Kosovare të Sigurimeve

Kandidate: Laura Mehmeti

Mentori: Prof.Asoc.Dr. Rrustem Qehaja

Byroja Kosovare e Sigurimeve si organizatë profesionale me cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllime jofitimprurëse, u formua më 07.09.2011 për të ofruar kompensim për viktimat e aksidenteve të trafikut rrugor nga shoferë të pasiguruar dhe më vonë shoferë të pa identifikur.

Byroja Kosovare e Sigurimeve është themeluar nga kompanitë e sigurimit për të operuar në Republikën e Kosovës, bazuar me Ligjin mbi sigurimin e autopërgjegjësive, e cila po ashtu financohet nga kompanitë e sigurimeve.

Synimi i këtij punimi master është të trajtojmë temën në lidhje me rolin dhe rëndësinë e Byrosë Kosovare të Sigurimeve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë rëndësisë së Byrosë, veprimtarisë së saj, strukturave organizative dhe funksionale, procedurave të trajtimit të dëmit deri tek realizimi i kërkesave palëve të dëmtuara duke u fokusuar në kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, në sigurimin e jetës, mbrojtjen e interesave të dëmtuarve, si dhe ti mbajë të informuar palët të dëmtuara në lidhje me sigurimet, ligjshmërinë, efikasitetin, stabilitetin, likuiditetin dhe aftësinë paguese të tyre, dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve.

***Fjalët Kyçe:** Byroja Kosovare e Sigurimeve; veprimtaria; struktura organizative dhe funksionale; procedurat e trajtimit të dëmit.*